



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës**  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

---

**RREGULLORE (AAC) Nr.04/2018**  
**PËR MENAXHIMIN E SIGURISË**

**REGULATION (CAA) No.04/2018**  
**FOR SAFETY MANAGEMENT**

**PRAVILNIK (ACV) Br.04/2018**  
**ZA UPRAVLJANJE BEZBEDNOSTI**

**Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 3.1, 3.4, 15.1, pikat (a) dhe (c), dhe 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) e Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të përcaktimit të kornizës ligjore për Menaxhimin e Sigurisë në përputhje me Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara të parapara në aneksin 19 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 04/2018 PËR  
MENAXHIMIN E SIGURISË**

**Neni 1  
Fusha e zbatimit**

1.1 Kjo rregullore përcakton kërkesat e Menaxhimit të Sigurisë në pajtim me Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara përkatëse (SPR-vë) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në aneksin 19 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

**Director General of Civil Aviation Authority of the Republic of Kosovo,**

Pursuant to Article 3.1, 3.4, 15.1 items (a) and (c) and 21.2, 78, 79 and 80 item (a) of Law No. 03/L-051 on Civil Aviation ("Official Gazette of the Republic of Kosovo" Year III, No. 28, 4 June 2008),

For the purpose of laying down legal framework for the Safety Management in line with Standards and Recommended Practices prescribed in Annex 19 to the Convention on International Civil Aviation,

Upon completion of the public consultation process with all interested parties pursuant to the Administrative Instruction no. 01/2012 on public consultation of interested parties,

Hereby issues the following:

**REGULATION No. 04/2018  
FOR SAFETY MANAGEMENT**

**Article 1  
Scope**

1.1 The present Regulation lays down requirements for Safety Management in accordance with respective Standards and Recommended Practices (SARP's) of International Civil Aviation Organization (ICAO), laid down in Annex 19 to the Convention on International Civil Aviation.

**Generalni Direktor Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Republike Kosovo,**

Na osnovu Članova 3.1, 3.4, 15.1 tačke (a) i (c) i 21.2, 78, 79 i 80 tačka (a) Zakona Br. 03/L-051 o Civilnom Vazduhoplovstvu („Službeni list Republike Kosovo“, godina III, broj 28, 4. jun 2008. godine),

U cilju uspostavljanja pravnog okvira za Upravljanje Bezbednosti u skladu sa Standardima i Preporučenim Praksama propisanim u Aneksu 19 Konvencije o Međunarodnom Civilnom Vazduhoplovstvu,

Nakon završetka procesa javnih konsultacija sa svim zainteresovanim stranama u skladu sa Administrativnim Uputstvom br. 01/2012 o javnim konsultacijama sa zainteresovanim stranama,

Donosi sledeći:

**PRAVILNIK (ACV) Br. 04/2018  
ZA UPRAVLJANJE BEZBEDNOSTI**

**Član 1  
Delokrug primene**

1.1 Ovj Pravilnik propisuje zahteve za Vazduhoplovne Karte u skladu sa odgovarajućim Standardima i Preporučenim Praksama (SARP's) Međunarodne Organizacije Civilnog Vazduhoplovstva (ICAO), koji su propisani u Aneksu 4 na Konvenciju o Međunarodnom Civilnom

1.2 Menaxhimi i Sigurisë në Republikën e Kosovës, do të rregullohet nga SPR-të e aneksit 19, siç është publikuar në Edicionin e II-të, korrik 2016 nga ONAC-i.

### **Neni 2 Zbatimi i SPR-ve**

2.1 Aneksi 19 mbi Menaxhimin e Sigurisë siç është përcaktuar në nenin 1 paragrafin 2 të kësaj rregulloreje, do të jetë i zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2.2 SPR-të e zbatueshme të specifikuara në Aneksin 19 dhe Shtojcat do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj rregulloreje përcaktojnë ndryshe.

### **Neni 3 Shprehjet dhe përkufizimet**

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje termat “Shtet Kontraktues”, “Shteti”, “Autoritet përkatës” drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 19 në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç është përcaktuar më sipër në nenin 1, paragrafin 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

3.2 Dallimet e listuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje në kuptim të kësaj rregulloreje nënkuptojnë qoftë shmangien nga standardi ose ngritjen e një praktike të rekomanduar në nivelin e standardit.

1.2 Aviation Safety Management in the Republic of Kosovo shall be governed by SARP's of Annex 19, as published in Edition 2, July 2016 by ICAO.

### **Article 2 Implementation of SARPs**

2.1 Annex 19 on Safety management, as specified under Article 1 paragraph 2 of the present Regulation shall be applicable in accordance with provisions of the present Regulation.

2.2 Applicable SARPs specified under Annex 19 and its Appendixes and Attachments shall be applicable in the Republic of Kosovo unless provisions of Article 4 of the present Regulation indicate otherwise.

### **Article 3 Terms and Definitions**

3.1 For the purposes of the present Regulation terms “Contracting State”, “The State” directly or indirectly either used in singular or plural in the Annex 19 to the Convention on International Civil Aviation, as specified above in Article 1 paragraph 2, shall be read “the Republic of Kosovo”.

3.2 Differences enlisted in Article 4 of the present Regulation shall in the meaning of the present Regulation mean either departure from the standard or raising a recommended practice to the level of a standard

Vazduhoplovstvu.

1.2 Pripremu Vazduhoplovnih Karata u Republici Kosovo regulišu SARP-ovi iz Aneksa 19, kao što je objavljeno u Izdanju 2, jula 2016. godine.

### **Član 2 Sprovođenje SARP-ova**

2.1 Aneks 19 za Upravljanje Bezbednosti, kao što je navedeno u Članu 1 stav 2 ovog Pravilnika, primenjuje se u skladu sa odredbama ovog Pravilnika.

2.2 Važeći SARP-ovi određeni u Aneksu 19, i njegovi Dodaci primenjuju se u Republici Kosovo, osim ako odredbe Člana 4 ovog Pravilnika ne nalažu drugačije.

### **Član 3 Izrazi i njihova značenja**

3.1 Za potrebe ove Uredbe, izrazi „Država Ugovornica“, „Država“, „Nadležni Autoritet“ direktno ili indirektno korišćeni u jednini ili množini u Aneksu 19 na Konvenciju o Međunarodnom Civilnom Vazduhoplovstvu, kao što su određeni u Članu 1 stav 2, označavaju „Republiku Kosovo“.

3.2 Razlike nabrojane u Članu 4 ovog Pravilnikaoznačavaju, u smislu ovog Pravilnika, ili odstupanje od standarda ili podizanje preporučene prakse na nivo standarda.

**Neni 4  
Dallimet nga SPR-të**

Nuk ka dallime nga SPR-të e Aneksit 19 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafin 2 të kësaj rregulloreje.

**Neni 5  
Disponueshmëria**

Teksti i rishikuar i SPR-ve të Aneksit 19, siç është specifikuar në nenin 1, paragrafin 2, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, i është bashkëngjitur kësaj rregulloreje si Shtojca 1.

**Neni 6  
Dispozitat përfundimtare**

Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk do të mbizotërojnë mbi dispozitat e rregulloreve tjera të AAC-së që miratojnë standarde të avancuara ose më strikte në fushën e mbuluar nga Aneksi 19 i Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

**Neni 7  
Shfuqizimi**

Kjo Rregullore do të shfuqizojë Rregulloren Nr. 1/2013 mbi zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).

**Neni 8  
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë

**Article 4  
Differences from SARP's**

No differences are applicable from SARP's of the Annex 19 to the Convention on International Civil Aviation as specified under Article 1, paragraph 2 of the present Regulation

**Article 5  
Availability**

The SARPs of Annex 19, as specified in Article 1, paragraph 2, in accordance with provisions of the present Regulation, are appended to the present Regulation as Annex 1.

**Article 6  
Final provisions**

Provisions of the present Regulation shall not prevail over the provisions of other CAA Regulations adopting advanced or more stringent standards on the field covered by Annex 19 to the Convention on International Civil Aviation.

**Article 7  
Repeals**

This Regulation shall repeal Regulation No. 1/2013 on implementation of Safety Management System (SMS).

**Article 8  
Entry into force**

This Regulation shall enter into force fifteen

**Član 4  
Razlike u odnosu na SARP-ove**

Nema razlike u odnosu na SARP-ove iz Aneksa 19 na Konvenciju o Međunarodnom Civilnom Vazduhoplovstvu, kao što su određeni u Članu 1, stav 2 ovog Pravilnika.

**Član 5  
Dostupnost**

Tekstovi revidiranih SARP-ova iz Aneksa 19, kao što su određeni u Članu 1, stav 2, u skladu sa odredbama ovog Pravilnika, priloženi su uz ovaj Pravilnik kao Dodatak 1.

**Član 6  
Završne odredbe**

Odredbe ovog Pravilnika neće nadvladati odredbe ostalih Uredbi ACV-a usvajanjem naprednih ili strožih standarda na oblasti koju pokriva Aneks 19 iz Konvencije o Međunarodnom Civilnom Vazduhoplovstvu.

**Član 7  
Stavljanje van snage**

Stupanjem na snagu ovog Pravilnika ukida se Pravilnik br. 1/2013 o sprovođenju Sistema Upravljanja Bezbednošću (SMS).

**Član 8  
Stupanje na snagu**

Ova Uredba stupa na snagu petnaest (15)

<p>(15) ditë pas nënshkrimit të saj.</p> <p>Prishtinë, 17 gusht 2018.</p> <p><b>Dritan Gjonbalaj</b> Drejtore i përgjithshëm</p>	<p>(15) days upon its signature.</p> <p>Pristina, on 17th August 2018</p> <p><b>Dritan Gjonbalaj</b> Director General</p>	<p>dana od dana potpisivanja.</p> <p>Priština, 17 august 2018 godine.</p> <p><b>Dritan Gjonbalaj</b> Generalni Direktor</p>
--	---	---

## **Shtojca 1 e Rregullores**

Aneksi 19

i Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar

Menaxhimi i Sigurisë

Edicioni i dytë, Korrik 2016

*Edicioni i parë 2013*

*Edicioni i dytë 2016*

# STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE PRAKTIKAT E REKOMANDUARA

## KAPITULLI 1. PËRKUFIZIMET

Atëherë kur termët në vijim përdoren në Standardet dhe Praktikrat e Referuara për Menaxhimin e Sigurisë, ato kanë këto kuptime:

**Aksident** - një ngjarje që lidhet me drejtimin e një avioni i cili në rastin e një avioni me njerëz ndodh ndërmjet kohës që një person hipën në avion me qëllim fluturimi deri në momentin e zbarkimit, apo në rastin e avionëve pa njerëz, ndodhë në kohën kur avioni është i gatshëm të lëvizë me qëllim të fluturimit deri në kohën kur të ndalet në fund të fluturimit dhe sistemi primar shtytës të jetë fikur, në të cilin:

a) personi lëndohet për vdekje ose rëndë si rezultat i:

- prezencës së tij/saj në avion, ose
- kontaktit të drejtpërdrejtë me një pjesë të avionit, përfshirë pjesët që janë shkëputur nga avioni, ose
- ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj shpërthimit nga motorët reaktiv,

*përveç* kur lëndimet shkaktohen nga shkaqe natyrore, janë të vet-shkaktuara ose të shkaktuara nga persona të tjerë, ose kur plagët u shkaktohen udhëtarëve të fshehur në mjedise të tjera nga ato që normalisht janë në dispozicion të pasagjereve dhe ekuipazhit; ose

b) avioni pëson dëmtim ose defekt strukturor që:

- ndikon negativisht në fuqinë strukturore, karakteristikat e performancës ose të fluturimit të avionit, dhe
- normalisht do të kërkonin riparim të konsiderueshëm ose zëvendësim të komponentit të prekur,

*përveç* defektit ose dëmtimit të motorit, kur dëmtimi kufizohet vetëm në motor (përfshirë mbrojtësen e motorit, ose aksesoret) për dëmet në helika, majat e krahëve, antenat, sondat, gomat, frenat, rrotat, panelet, dyert e pajisjeve të aterimit, xhamat, trupi i avionit (dëmtime apo vrima të vogla) apo dëmtimet e vogla në presat kryesore të rotorit, pajisje të aterimit, dhe atyre që rezultojnë nga breshëri apo sulmet e zogjve (përfshirë edhe vrimat në mbështjellës); apo

c) avioni ka humbur ose është plotësisht i pa-qasshëm.

*Shënim 1.— Për qëllime të uniformitetit statistikor, lëndimi që rezulton në vdekje brenda tridhjetë ditëve nga data kur aksidenti klasifikohet nga ICAO si plagosje me vdekje.*

*Shënim 2.— Kur avioni konsiderohet se mungon kur kërkimi zyrtar ka përfunduar dhe nuk është lokalizuar mbetja.*

*Shënim 3.— Lloji i sistemit të avionit pa pilot që duhet të hetohet është trajtuar në 5.1 të aneksit 13.*

*Shënim 4.— Udhëzimi për përcaktimin e dëmit të avionit mund të gjendet në shtesën E të aneksit 13.*

**Aeroplani.** Avion me energji që është më i rëndë se ajri, i cili arrin të ngrihet kryesisht me ndihmën e reaksioneve aerodinamike në sipërfaqe të cilat mbesin të vendosur nën kushte të caktuara të fluturimit.

**Avioni.** Çdo makinë që mund të krijojë mbështetje në atmosferë nga reaksionet e ajrit përveç reaksioneve të ajrit kundër sipërfaqes së tokës.

**Rrezik.** Gjendja apo ndonjë objekt me potencial për shkaktimin apo kontribuimin në një incident apo aksident të avionit.

**Helikopter.** Avion më i rëndë se ajri kryesisht i mbështetur në fluturim nga reaksionet e ajrit në një apo më shumë rotorë me energji në akse vertikale.

*Shënim.— Disa shtete përdorin termin “rotorcraft” si alternativë për “helikopter”.*

**Incident.** Një ndodhi, përveç aksidentit, i ndërlidhur me operimin e një avioni që ndikon apo mund të ndikojë në sigurinë e operacionit.

*Shënim.— Llojet e incidenteve që janë me interes për studimet e ndërlidhura me sigurinë përfshijnë incidentet e radhitura në aneksin 13, Shtojcën C.*

**Kodet e praktikës në industri.** Materiali udhëzues i zhvilluar nga një organ i industrisë për një sektor të veçantë të industrisë së aviacionit për të plotësuar kërkesat që dalin nga Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara, kërkesat tjera të sigurisë së aviacionit dhe praktikat më të mira që konsiderohen të përshtatshme.

*Shënim.— Disa shtete pranojnë dhe u referohen kodeve të praktikës në industri gjatë zhvillimit të rregulloreve për përmbushjen e kërkesave që dalin nga aneksi 19 dhe vënë burimet e tyre dhe mënyrën se si mund të merren ato në dispozicion të kodeve të praktikës në industri.*

**Personeli operativ.** Personeli i përfshirë në aktivitetet e aviacionit që janë në pozitë të raportojnë informacionet e sigurisë.

*Shënim.— Personeli i tillë përfshinë, por nuk kufizohet në ekuipazhin e fluturimit, kontrolluesit e trafikut ajror, operatorët e stacionit aeronautikë, teknikët e mirëmbajtjes, personeli i organizatave për dizajnimin dhe prodhimin e avionëve, ekuipazhi i kabinës, dispeçerët e fluturimit, personeli i platformës dhe personeli për trajtim në tokë.*

**Siguria.** Gjendja në të cilën rreziku që shoqërohet me aktivitete të aviacionit, që ndërlidhen apo drejtpërdrejtë mbështesin operimin e një avioni, kontrollohet dhe zvogëlohet deri në një nivel të pranueshëm.



**Të dhënat mbi sigurinë.** Një grup i përcaktuar i fakteve apo grup i vlerave të sigurisë të mbledhura nga burime të ndryshme të ndërlidhura me aviacionin, që përdoren për ruajtjen apo përmirësimin e sigurisë.

*Shënim.— Të dhënat e tilla të sigurisë të mbledhura nga aktivitetet proaktive apo reaktive të ndërlidhura me sigurinë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:*

- a) hetimet e aksidenteve apo incidenteve;
- b) raportimin e sigurisë;
- c) vazhdimin e raportimit të vlefshmërisë ajrore;
- d) monitorimin e performancës operative;
- e) inspektimet, auditimet, anketat; apo
- f) studimet dhe shqyrtimet e sigurisë.

**Informacionet mbi sigurinë.** Të dhënat mbi sigurinë të përpunuara, organizuara apo analizuara në një kontekst të caktuar në mënyrë që t'i bëjnë të dobishme për qëllime të menaxhimit të sigurisë.

**Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).** Një qasje sistematike për menaxhimin e sigurisë, përfshirë strukturat e nevojshme organizative, llogaridhënien, përgjegjësitë, politikat dhe procedurat.

**Mbikëqyrja e sigurisë.** Funkzioni i kryer nga shteti për të siguruar që individët dhe organizatat që kryejnë aktivitet të aviacionit respektojnë ligjet dhe rregulloret kombëtare të ndërlidhura me sigurinë.

**Performanca e sigurisë.** Arritja e sigurisë së shtetit apo ofruesit të shërbimit siç përcaktohet nga objektivat e tij të performancës së sigurisë dhe treguesit e performancës së sigurisë.

**Treguesi i Performancës së Sigurisë.** Një parametër i bazuar në të dhëna, i përdorur për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së sigurisë.

**Objektivi i Performancës së Sigurisë.** Objektivi i planifikuar apo i synuar i shtetit apo ofruesit të shërbimit për treguesin e performancës së sigurisë gjatë një periudhe të caktuar që është në përputhje me objektivat e sigurisë.

**Rreziku i sigurisë.** Probabiliteti dhe ashpërsia e parashikuar e pasojave apo rezultateve të rrezikut.

**Lëndimi i rëndë.** Lëndimi që e pëson personi në një aksident dhe i cili:

- a) kërkon shtrim në spital për më shumë se 48 orë duke filluar brenda 7 ditëve nga data kur ka ndodhur lëndimi; apo
- b) rezulton në thyerjen të ndonjë eshtëri (përveç thyerjeve të thjeshta të gishtave, thonjve apo hundës); apo
- c) përfshinë gërvishtje që shkaktojnë hemorragji të rëndë, dëmtim të nervit, muskulit apo të tendonit; apo
- d) përfshinë dëmtim në ndonjë organ të brendshëm; apo

- e) përfshinë djegie të shkallës së dytë apo të tretë, apo djegie që prekin më shumë se 5 përqind të sipërfaqes së trupit; apo
- f) përfshinë ekspozimin e verifikuar ndaj substancave infektuese apo rrezatimit lëndues.

**Shteti i dizajnit.** Shteti që ka juridiksion mbi organizatën që është përgjegjëse për dizajnin e llojit.

**Shteti i prodhimit.** Shteti që ka juridiksion mbi organizatën që është përgjegjëse për montimin përfundimtar të avionit.

**Shteti i operatorit.** Shteti në të cilin gjendet vendi kryesor i biznesit i operatorit apo, nëse nuk ka vend të tillë të biznesit, banimi i përhershëm i operatorit.

**Programi Shtetëror i Sigurisë (PSHS).** Një grup i integruar i rregulloreve dhe aktiviteteve që kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë.

**Mbikëqyrja.** Aktivitetet shtetërore të cilat shteti i verifikon në mënyrë proaktive nëpërmjet inspektimeve dhe auditimeve që mbajtesi i licencës të aviacionit, certifikatës, autorizimit apo aprovimit që vazhdon të plotësojë kërkesat dhe funksionin në nivel të kompetencës dhe sigurisë së kërkuar nga shteti.

---

## KAPITULLI 2. ZBATUESHMËRIA

Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara të përfshira në këtë aneks janë të aplikueshme për funksionet e menaxhimit të sigurisë të ndërlidhura apo në mbështetje të drejtpërdrejtë të drejtimit të sigurt të avionit.

*Shënimi 1.— Dispozitat e menaxhimit të sigurisë për shtetet janë përfshirë në kapitullin 3 dhe ndërlidhen me programin shtetëror të sigurisë.*

*Shënimi 2.— Në kuadër të këtij aneksi, termi “ofruer i shërbimit” i referohet atyre organizatave të radhitura në kapitullin 3, 3.3.2.1 dhe nuk përfshinë operatorët ndërkombëtar të aviacionit të përgjithshëm.*

*Shënimi 3.— Dispozitat për menaxhimin e sigurisë për ofruer dhe operatorë të specifikuar të aviacionit janë në kapitullin 4 dhe ndërlidhen me Sistemet për Menaxhimin e Sigurisë (SMS-të).*

*Shënimi 4.— Asnjë dispozitë e këtij aneksi nuk synon transferimin e përgjegjësisë të ofruerit apo operatorit të shërbimeve të aviacionit tek shteti. Kjo përfshinë funksionet e ndërlidhura apo në mbështetje të drejtpërdrejtë të drejtimit të sigurt të avionit.*

*Shënimi 5.— Në kontekst të këtij aneksi, “përgjegjësia” (njëjës) i referohet “përgjegjësisë shtetërore” në lidhje me obligimet ndërkombëtare sipas Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, përderisa*

“përgjegjësitë” (shumës) duhet të marrin kuptimin e zakonshëm (d.m.th. kur i referohen funksioneve dhe aktiviteteve që mund të delegohen).

---

## KAPITULLI 3. PËRGJEGJËSITË SHETËRORE PËR MENAXHIMIN E SIGURISË

*Shënimi 1.— Elementet Kritike (EK-të) të sistemit shtetëror të Mbikëqyrjes së Sigurisë (MSSH) që gjenden në shtojcën 1 përbëjnë bazën të një MSSH-je.*

*Shënimi 2.— Dispozitat për menaxhimin e sigurisë që i përkasin llojeve specifike të aktiviteteve të aviacionit janë trajtuar në anekse përkatëse.*

*Shënimi 3.— Parimet themelore të sigurisë të zbatueshme për procesin e vlerësimit mjekësor të mbajtësve të licencës përfshihen në aneksin 1. Udhëzuesi është në dispozicion në Manualin e Mjekësisë së Aviacionit Civil (Dokumenti 8984).*

### 3.1 Programi Shtetëror i Sigurisë (PSHS)

Shtetet krijojnë dhe mirëmbajnë një PSSH që është në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e sistemit të aviacionit civil të shtetit, por mund t’ia delegojnë funksionet dhe aktivitetet e ndërlidhura me menaxhimin e sigurisë një shteti tjetër, Organizate për Mbikëqyrjen e Sigurisë Rajonale (RSOO) apo Organizate Rajonale për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve (RAIO).

*Shënimi 1.— Shtetet mbajnë përgjegjësinë për funksionet dhe aktivitetet të ndërlidhura me menaxhimin e sigurisë të deleguara tek një shtet tjetër, RSOO apo RAIO.*

*Shënimi 2.— Udhëzuesi mbi PSHS dhe delegimi i funksioneve dhe aktiviteteve të ndërlidhura me menaxhimin e sigurisë përfshihen në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dokumenti 9859).*

### 3.2 Politikat shtetërore të sigurisë, objektivat dhe burimet

#### 3.2.1 Legjislacioni primar i aviacionit

3.2.1.1 Shtetet përcaktojnë legjislacionin primar të aviacionit në përputhje me seksionin 1 të Shtojcës 1.

3.2.1.2 **Rekomandim.**— Shtetet duhet të krijojnë një politikë të zbatimit që specifikon kushtet dhe rrethanat në të cilat ofruesve të shërbimeve me SMS iu lejohet që të merren dhe të zgjidhin ngjarjet që përfshijnë çështje të caktuara të sigurisë, në nivel të brendshëm, brenda kontekstit të SMS së tyre dhe në përputhje me autoritetit të duhur shtetëror.

### 3.2.2 Rregulloret specifike të operimit

3.2.2.1 Shtetet përcaktojnë rregulloret specifike të operimit në përputhje me seksionin 2 të shtojcës 1.

3.2.2.2 Shtetet shqyrtojnë në baza periodike rregulloret specifike të operimit, materialin udhëzues dhe politikat e zbatimit për të siguruar që ato mbesin relevante dhe adekuate.

### 3.2.3 Sistemi shtetëror dhe funksionet

3.2.3.1 Shtetet përcaktojnë sistemin shtetëror dhe funksionet në përputhje me seksionin 2 të shtojcës 1.

3.2.3.2 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të identifikojnë, përkufizojnë dhe dokumentojnë kërkesat, obligimet, funksionet dhe aktivitetet sa i përket krijimit dhe mirëmbajtjes së PSHS, përfshirë direktivat për planifikimin, organizimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të PSHS në një mënyrë që plotëson objektivat e shtetit për siguri..*

3.2.3.3 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të përcaktojnë politikën e sigurisë dhe objektivat e sigurisë që pasqyrojnë zotimin e tyre sa i përket sigurisë dhe lehtësojnë promovimin e kulturës pozitive të sigurisë në komunitetin e aviacionit.*

3.2.3.4 **Rekomandim.**— *Politika e sigurisë dhe objektivat e sigurisë duhet të publikohen dhe të shqyrtohen në mënyrë periodike për të siguruar që ato janë relevante dhe adekuate për shtetin.*

### 3.2.4 Personeli i kualifikuar teknik

Shtetet përcaktojnë kërkesat për kualifikimin e personelit teknik në përputhje me seksionin 4 të shtojcës 1.

*Shënim.*— *Termi “personel teknik” i referohet personave që kryejnë funksione të ndërlidhura me sigurinë për apo në emër të shtetit.*

### 3.2.5 Udhëzuesi teknik, mjetet dhe ofrimi i informacioneve të rëndësishme për sigurinë

Shtetet përcaktojnë udhëzues dhe mjete teknike dhe ofrojnë informacione kritike për sigurinë në përputhje me seksionin 5 të shtojcës 1.

## 3.3 Menaxhimi shtetëror i rrezikut të sigurisë

### 3.3.1 Obligimet për licencim, certifikim, autorizim dhe aprovim

Shtetet plotësojnë nevojat për licencim, certifikim, autorizim dhe aprovim në përputhje me seksionin 6 të shtojcës 1.

### 3.3.2 Obligimet për sistemin e menaxhimit të sigurisë

#### 3.3.2.1 Shtetet kërkojnë që këta ofrues të shërbimeve të zbatojnë nën autoritetin e tyre një SMS:

- a) organizatat e aprovuara për trajnim në përputhje me aneksin 1 që i ekspozohen rreziqeve të sigurisë të ndërlidhura me operacionet e aviacionit gjatë ofrimit të shërbimeve;
- b) operatorët e aeroplanëve apo helikopterëve të autorizuar për realizimin e transportit ndërkombëtar komercial, në përputhje me aneksin 6, pjesa I apo pjesa III, seksioni II, përkatësisht;

*Shënim.— Atëherë kur aktivitetet e mirëmbajtjes nuk realizohen nga një organizatë e aprovuar për mirëmbajtje në përputhje me aneksin 6, pjesa I, 8.7, por nën një sistem ekuivalent si në aneksin 6, pjesa I, 8.1.2, apo pjesa III, seksioni II, 6.1.2, ato përfshihen në fushëveprimin e SMS të operatorit.*

- c) organizatat e aprovuara të mirëmbajtjes që ofrojnë shërbime për operatorët e aeroplanëve apo helikopterëve të angazhuar në transportin ndërkombëtar ajror komercial, në përputhje me aneksin 6, pjesën I apo pjesën III, seksioni II, përkatësisht;
- d) organizatat përgjegjëse për dizajnin e llojit apo prodhimin e avionit, motorëve apo helikave në përputhje me aneksin 8;
- e) ofruesit e Shërbimeve të Trafikut Ajror (SHTA) në përputhje me aneksin 11; dhe
- f) operatorët e aerodromeve të certifikuar në përputhje me aneksin 14, Vëllimi I.

*Shënim.— Dispozitat e mëtejshme të ndërlidhura me zbatimin e SMS nga ofruesit e shërbimeve mund të gjenden në kapitullin 4.*

**3.3.2.2 Rekomandim.**— *Shtetet duhet të sigurojnë që treguesit e performancës së sigurisë dhe objektivat e përcaktuar nga ofruesit dhe operatorët e shërbimeve janë të pranueshëm për shtetin.*

*Shënim.— Udhëzuesi për identifikimin e treguesve dhe objektiveve të duhur të performancës së sigurisë përfshihet në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dokumenti 9859).*

**3.3.2.3** Shteti i Regjistrimit përcakton kriteret për operatorët e përgjithshëm ndërkombëtar të aviacionit apo aeroplanët me motorë turbo-reaktiv në përputhje me aneksin 6, pjesën II, seksionin 3, për të zbatuar një SMS.

*Shënim.— Dispozitat e mëtejshme të ndërlidhura me zbatimin e SMS nga operatorët e përgjithshëm ndërkombëtar të aviacionit mund të gjenden në kapitullin 4.*

**3.3.2.4** Kriteret e përcaktuara nga Shteti i Regjistrimit në përputhje me 3.3.2.3 adresojnë kornizën dhe elementet e SMS të përfshira në shtojcën 2.

*Shënim.— Udhëzuesi për përcaktimin e kriterëve për zbatimin e një SMS për operatorët e përgjithshëm ndërkombëtar të aviacionit përfshihet në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dokumenti 9859).*

### 3.3.3 Hetimi i aksidenteve dhe incidenteve

Shtetet përcaktojnë një proces për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në përputhje me aneksin 13, në mbështetje të menaxhimit të sigurisë në shtet.

### 3.3.4 Identifikimi i rrezikut dhe vlerësimi i rrezikut të sigurisë

3.3.4.1 Shtetet përcaktojnë dhe ruajnë një proces për identifikimin e rreziqeve nga të dhënat e mbledhura të sigurisë.

*Shënim 1. — Informacionet e mëtejshme sa i përket mbledhjes së të dhënave të sigurisë, analizës dhe ndarjes dhe shkëmbimit të informacioneve të sigurisë mund të gjenden në kapitullin 5.*

*Shënim 2.— Informacionet shitesë për identifikimin e rreziqeve dhe çështjeve të sigurisë mbi të cilat duhet të bazohen veprimet parandaluese të përfshira në raportet përfundimtare të aksidenteve dhe incidenteve.*

3.3.4.2 Shtetet zhvillojnë dhe mirëmbajnë një proces që siguron vlerësimin e rreziqeve të sigurisë të ndërlydhura me rreziqet e identifikuara.

### 3.3.5 Menaxhimi i rreziqeve të sigurisë

3.3.5.1 Shtetet themelojnë mekanizma për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë në përputhje me seksionin 8 në shtojcën 1.

3.3.5.2 **Rekomandim.**— Shtetet duhet të zhvillojnë dhe mirëmbajnë një proces për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë.

*Shënim 1.— Veprimet e ndërmarra për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë mund të përfshijnë: pranimin, lehtësimin, shmangien apo transferimin.*

*Shënim 2.— Rreziqet e sigurisë dhe çështjet e sigurisë shpesh kanë faktorë themelorë që duhet të vlerësohen me kujdes.*

## 3.4 Garantimi shtetëror i sigurisë

### 3.4.1 Obligimet për mbikëqyrje

3.4.1.1 Shtetet duhet të përmbushin obligimet për mbikëqyrje në përputhje me seksionin 7 të shtojcës 1.

*Shënim.— Mbikëqyrja e ofruesve të shërbimit merr parasysh performancën e sigurisë, si dhe madhësinë dhe kompleksitetin e produkteve apo shërbimeve të tij të aviacionit.*

3.4.1.2 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të përcaktojnë procedura për prioritizimin e inspektiveve, auditiveve dhe anketave drejt atyre fushave me më shumë shqetësim për apo nevojë për siguri.*

*Shënim.*— *Profilet organizative të rrezikut, rezultatet e identifikimit të rrezikut dhe vlerësimi i rrezikut, si dhe rezultatet e mbikëqyrjes mund të ofrojnë informacione për prioritizimin e inspektiveve, auditiveve dhe anketave.*

3.4.1.3 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të shqyrtojnë në baza periodike performancën e sigurisë së një ofruesi individual të shërbimit.*

### 3.4.2 Performanca e sigurisë së shtetit

3.4.2.1 Shtetet përcaktojnë nivelin e pranueshëm të performancës së sigurisë që duhet të arrihet nëpërmjet PSHS të tyre.

*Shënim 1.*— *Niveli i pranueshëm i performancës së sigurisë për Shtetin mund të arrihet nëpërmjet zbatimit dhe mirëmbajtjes së SSP, si dhe treguesve dhe objektivave të performancës së sigurisë që tregojnë se siguria menaxhohet në mënyrë efikase dhe bazohet në themelin e zbatimit të SARP ekzistuese të ndërlidhura me sigurinë.*

*Shënim 2.*— *Udhëzuesi për përcaktimin e treguesve dhe objektivave të performancës së sigurisë, si dhe një nivel i pranueshëm i performancës së sigurisë, përfshihen në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dokumenti 9859).*

3.4.2.2 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të zhvillojnë dhe mirëmbajnë një proces për të vlerësuar efikasitetin e veprimeve të ndërmarra për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë dhe zgjidhjen e çështjeve të sigurisë.*

*Shënim.*— *Rezultatet e vlerësimit të sigurisë mund të përdoren për të mbështetur prioritizimin e veprimeve për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë.*

3.4.2.3 **Rekomandim.**— *Shtetet duhet të vlerësojnë efikasitetin e PSHS-ve të tyre individuale për të mirëmbajtur apo përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme nivelin e përgjithshëm të performancës së sigurisë.*

## 3.5 Promovimi i sigurisë nga shteti

### 3.5.1 Komunikimi i brendshëm dhe shpërndarja e informacioneve të sigurisë

**Rekomandim.**— *Shtetet duhet të promovojnë vetëdijesimin mbi sigurinë si dhe ndarjen dhe shkëmbimin e informacioneve mbi sigurinë për të mbështetur zhvillimin e një kulture pozitive të sigurisë që nxit një PSHS efikas në kuadër të organizatave të aviacionit të Shtetit.*

### 3.5.2 Komunikimi i jashtëm dhe shpërndarja e informatave të sigurisë

**Rekomandim.**— *Shtetet duhet të promovojnë vetëdijesimin për sigurinë si dhe ndarjen dhe shkëmbimin e informacioneve të sigurisë me komunitetin e aviacionit për të nxitur mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sigurisë dhe mbështetjen e zhvillimit të kulturës pozitive të sigurisë.*

*Shënim 1.*— *Referojuni kapitullit 5, 5.4, për detaje të mëtejshme sa i përket ndarjes dhe shkëmbimit të informacioneve mbi sigurinë.*

*Shënim 2.*— *Promovimi i vetëdijesimit mbi sigurinë do të mund të përfshinte identifikimin e trajnimit të qasshëm të sigurisë për komunitetin e aviacionit.*

---

## KAPITULLI 4. SISTEMI PËR MENAXHIMIN E SIGURISË (SMS)

*Shënim 1.*— *Udhëzuesi mbi zbatimin e SMS përfshihet në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dokumenti 9859).*

*Shënim 2.* — *Një organizatë mund të zgjedh që të vendos një SMS përgjatë aktiviteteve të shumëfishta të ofruesit të shërbimeve.*

### 4.1 Të përgjithshme

4.1.1 SMS e një ofruesi të shërbimit duhet të:

- a) themelohet në përputhje me elementet kornizë të përfshirë në shtojcën 2; dhe
- b) jetë në përputhje me madhësinë e ofruesit të shërbimit dhe kompleksitetin e produkteve apo shërbimeve të tij të aviacionit.

4.1.2 Shteti siguron që ofruesi i shërbimit zhvillon një plan për lehtësimin e zbatimit të SMS.

4.1.3 SMS e një organizate të aprovuar të trajnimit, në përputhje me aneksin 1, që i ekspozohet rreziqeve të sigurisë të ndërlihdura me operacionet e avionit gjatë ofrimit të shërbimeve të tij, bëhet e pranueshme për shtetin/shtetet që janë përgjegjëse për aprovimin e organizatës.

4.1.4 SMS e operatorit të certifikuar të aeroplanëve apo helikopterëve të autorizuar për realizimin e transportit ndërkombëtar ajror komercial, në përputhje me aneksin 6, pjesën I apo pjesën III, përkatësisht seksionin II, bëhen të pranueshme për Shtetin e Operatorit.

*Shënim.*— *Atëherë kur aktivitetet e mirëmbajtjes nuk realizohen nga një organizatë e aprovuar për mirëmbajtje në përputhje me Shtojcën 6, pjesën I, 8.7, por nën një sistem ekuivalent si në shtojcën 6, pjesën I, 8.1.2, apo pjesën III, seksionin II, 6.1.2, ato përfshihen në fushëveprimin e SMS të operatorit.*

4.1.5 SMS e një organizate të aprovuar të mirëmbajtjes që ofron shërbime për operatorët e aeroplanëve apo



helikopterëve të angazhuar në transportin ndërkombëtar ajror komercial, në përputhje me aneksin 6, pjesën I apo pjesën III, përkatësisht seksionin II, bëhen të pranueshme për shtetin/shtetet përgjegjëse për aprovimin e organizatës.

4.1.6 SMS e një organizate përgjegjëse për dizajnin e llojit të një avioni, motorëve apo helikave, në përputhje me aneksin 8, bëhet i pranueshëm për Shtetin e Dizajnit.

4.1.7 SMS e një organizate përgjegjëse për prodhimin e një avioni, motorëve apo helikave, në përputhje me aneksin 8, bëhet i pranueshëm për Shtetin e Prodhimit.

4.1.8 SMS e ofruesit të ATS, në përputhje me aneksin 11, bëhet i pranueshëm për shtetin që është përgjegjës për përcaktimin e ofruesit.

4.1.9 SMS i një operatori të aerodromit të certifikuar, në përputhje me aneksin 14, Vëllimin I, bëhen të pranueshme për Shtetin përgjegjës për certifikimin e aerodromit.

## **4.2 Aviacioni i përgjithshëm ndërkombëtar - aeroplanët**

*Shënim - Udhëzuesi mbi zbatimin e SMS-së për aviacionin e përgjithshëm ndërkombëtar është përfshirë në Manualin e Menaxhimit të Sigurisë (SMM) (Doc 9859) dhe kodet e praktikës së industrisë.*

SMS i një operatori të aviacionit të përgjithshëm ndërkombëtar, që kryen operatione për aeroplanët e mëdhenj ose turbo-jet në përputhje me Aneksin 6, Pjesa II, Seksioni 3, duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë dhe kompleksitetin e operacionit dhe të plotësojë kriteret e përcaktuara nga Shteti i Regjistrimit.

*Shënim 1.- Dispozitat e mëtejme në lidhje me kriteret që duhet të përcaktohen nga shteti i regjistrimit mund të gjenden në Kapitullin 3.*

*Shënim 2.- Udhëzuesi mbi përgjegjësitë e Shtetit të Regjistrimit lidhur me operationet e lizingut, charter dhe të shkëmbimit është përfshirë në Manualin e Procedurave për Inspektimin, Certifikimin dhe Survejimin (mbikëqyrjen) e Vazhdueshme (Dok 8335). Udhëzuesi lidhur me transferimin e përgjegjësive të Shtetit të Regjistrimit tek Shteti ku operatori i avionëve ka vendin e tij kryesor të biznesit ose, nëse nuk ka një vend të tillë biznesi, adresën e tij të përhershme në përputhje me nenin 83 është përfshirë në Manualin për Zbatimin e nenit 83 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (Dok. 10059).*

## KAPITULLI 5. MBLEDHJA, ANALIZA, MBROJTJA, NDARJA DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMATAVE MBI SIGURINË

*Shënim.- Qëllimi i këtij kapitulli është të sigurojë disponueshmërinë e vazhdueshme të të dhënave dhe informatave të sigurisë për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të sigurisë.*

### 5.1 Sistemet e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të sigurisë

5.1.1 Shtetet duhet të krijojnë sisteme për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të sigurisë (SMPDhS) për të kapur, ruajtur, grumbulluar dhe mundësuar analizën e të dhënave dhe informatave të sigurisë.

*Shënimi 1.- SMPDhS i referohet sistemeve të përpunimit dhe raportimit, bazave të të dhënave të sigurisë, skemave për shkëmbimin e informatave dhe informatave të regjistruara duke përfshirë, por pa u kufizuar në:*

- a) *Të dhënat dhe informatat që kanë të bëjnë me hetimet e aksidenteve dhe incidenteve;*
- b) *Të dhënat dhe informatat në lidhje me hetimet e sigurisë nga autoritetet shtetërore ose ofruesit e shërbimeve të aviacionit;*
- c) *Sistemet e raportimit të detyrueshëm mbi sigurinë siç tregohet në 5.1.2;*
- d) *Sistemet e raportimit vullnetarë mbi sigurinë siç tregohet në 5.1.3; dhe*
- e) *Sistemet raportuese vetë-zbuluese, duke përfshirë sistemet automatike të kapjes së të dhënave, siç përshkruhet në Aneksin 6, Pjesa I, Kapitulli 3, si dhe sistemet manuale të kapjes së të dhënave.*

*Shënim 2.- Udhëzuesi lidhur me SMPDhS është përfshirë në Manualin për Menaxhimin e Sigurisë (MMS) (Dok 9859).*

*Shënim 3.- Termi "Baza e të dhënave të sigurisë" mund t'i referohet një baze të vetme të të dhënave ose bazave të shumëfishta të të dhënave.*

*Shënimi 4.- SMPDhS mund të përfshijë inpute nga shteti, industria dhe burimet publike dhe mund të bazohet në metoda reaktive dhe proaktive të të dhënave të sigurisë dhe mbledhjes së informatave të sigurisë.*

*Shënim 5.-Dispozitat specifike për sektor mbi raportimin e sigurisë përfshihen në anekset tjerë, PANS dhe SUPP. Njihet përfitimi për zbatimin efektiv të një PSSh në qasjen e integruar për mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informatave të sigurisë nga të gjitha burimet.*

5.1.2 Shtetet do të krijojnë një sistem të raportimit të detyrueshëm mbi sigurinë që përfshin raportimin e incidenteve.

5.1.3 Shtetet duhet të krijojnë një sistem të raportimit vullnetar mbi sigurinë për të mbledhur të dhëna dhe informata të sigurisë të cilat nuk kapen nga sistemet e detyrueshme të raportimit mbi sigurinë.

**5.1.4 Rekomandim.**— *Autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e PSSh-së duhet të kenë qasje në SMPDhS siç referohet në 5.1.1 për të mbështetur përgjegjësitë e tyre të sigurisë, në përputhje me parimet e Shtojcës 3.*

*Shënim: Autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e PSSh-së përfshijnë autoritetet e hetimit të aksidenteve.*

**5.1.5 Rekomandim.**— *Baza e të dhënave të sigurisë duhet të përdorë taksonominë e standardizuar për të lehtësuar shkëmbimin e informatave të sigurisë.*

*Shënim.- Shtetet inkurajohen të përdorin një sistem kompatibil me ADREP. Më shumë informata për ADREP mund të gjenden në Aneksin 13, Kapitulli 7.*

## **5.2 Analiza e të dhënave dhe informatave të sigurisë**

5.2.1 Shtetet duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë një proces për të analizuar të dhënat dhe informatat e sigurisë nga SMPDhS dhe bazat e ndërlidhura të të dhënave të sigurisë.

*Shënim 1.- Dispozitat specifike shtetërore për identifikimin e rreziqeve si pjesë e menaxhimit të rrezikut të sigurisë dhe proceseve të sigurimit të sigurisë mund të gjenden në Kapitullin 3.*

*Shënim 2.- Qëllimi i analizave së të dhënave dhe informatave të sigurisë të kryera nga shteti është që të identifikohen rreziqet sistematike dhe ndër-sektoriale që mund të mos identifikohen ndryshe nga proceset e analizës së të dhënave të sigurisë nga ofruesit e shërbimeve individuale dhe operatorët.*

*Shënim 3.- Procesi mund të përfshijë metoda parashikuese të analizës së të dhënave të sigurisë.*

## **5.3 Mbrojtja e të dhënave dhe informatave të sigurisë**

5.3.1 Shtetet duhet të sigurojnë mbrojtje për të dhënat e sigurisë të kapura, dhe informatat e sigurisë të nxjerra nga sistemet e raportimit vullnetar të sigurisë dhe burimet përkatëse në përputhje me Shtojcën 3.

*Shënim: Burimet përfshijnë individë dhe organizata.*

**5.3.2 Rekomandim.-** *Shtetet duhet të ofrojnë mbrojtjen e referuar në 5.3.1 edhe për të dhënat dhe informatat e sigurisë të nxjerra nga sistemi i raportimit të detyrueshëm mbi sigurinë dhe burimet e ngjashme.*

*Shënim 1.- Një mjedis i raportimit ku punonjësit dhe personeli operativ mund të besojnë se veprimet ose mosveprimet e tyre që janë në përpjesëtim me trajnimin dhe përvojën e tyre nuk do të ndëshkohen, është thelbësor për raportimin e sigurisë.*

*Shënim 2.- Udhëzuesi në lidhje me sistemet e raportimit të detyrueshëm dhe vullnetar të sigurisë është përfshirë në Manualin e Menaxhimit të Sigurisë (MMS) (Dok 9859).*

5.3.3 Sipas 5.3.1 dhe 5.3.2, Shtetet nuk duhet të vënë në dispozicion ose të përdorin të dhëna ose informata mbi sigurinë të mbledhura, ruajtura ose të analizuara në përputhje me 5.1 ose 5.2 për qëllime të tjera jashtë mirëmbajtjes ose përmirësimit të sigurisë, përveç nëse autoriteti kompetent përcakton, në përputhje me Shtojcën 3, se mund të aplikohet parimi i përjashtimit.

5.3.4 Pavarësisht nga 5.3.3, Shtetet nuk duhet të parandalohen nga përdorimi i të dhënave ose informatave të sigurisë për ndërmarrjen e ndonjë veprim parandalues, korrektues ose përmirësues që është i nevojshëm për të ruajtur ose përmirësuar sigurinë e aviacionit.

*Shënim: - Dispozitat specifike që kanë për qëllim të sigurojnë se nuk ka mbivendosje (dyfishim) për mbrojtjen e të dhënave të hetimit në Aneksin 13 përfshihet në Shtojcën 3, 1.2.*

5.3.5 Shtetet duhet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë promovimin e një kulture pozitive të sigurisë për të inkurajuar raportimin e sigurisë nëpërmjet sistemeve të referuara në 5.1.2 dhe 5.1.3.

*Shënim. – Udhëzuesi i lidhur me kulturën pozitive të sigurisë është përfshirë në Manualin e Menaxhimit të Sigurisë (MMS) (Dok 9859.)*

5.3.6 **Rekomandim.**— Shtetet duhet të lehtësojnë dhe promovojnë raportimin e sigurisë duke përshtatur ligjet, rregulloret dhe politikat e tyre në fuqi sipas nevojës.

5.3.7 **Rekomandim.**— Në mbështetje të përcaktimit të referuar në 5.3.3, Shtetet duhet të krijojnë dhe të përdorin aranzhimet e duhura paraprake ndërmjet autoriteteve të tyre dhe organeve shtetërore të ngarkuara me sigurinë e aviacionit dhe atyre që janë të ngarkuar me administrimin e drejtësisë. Aranzhimet e tilla duhet të marrin parasysh parimet e specifikuara në Shtojcën 3.

*Shënim: Këto aranzhime mund të formalizohen përmes legjislacionit, protokolleve, marrëveshjeve ose memorandumeve të mirëkuptimit.*

## **5.4 Ndarja dhe shkëmbimi i informatave për siguri**

*Shënim: Ndarja i referohet dhënies, ndërsa shkëmbimi i referohet dhënies dhe pranimit në këmbim.*

5.4.1 Nëse një shtet, në analizën e informatave që përmban në SMPDhS, identifikon çështje të sigurisë të cilat konsiderohen se janë me interes për shtetet tjera, ai Shtet duhet t'i përcjellë ato informata sa më shpejt që është e mundur. Para se të ndajë një informate të tillë, Shtetet duhet të bien dakord mbi nivelin e mbrojtjes dhe kushteve mbi të cilat informatat e sigurisë do të ndahen. Niveli i mbrojtjes dhe i kushteve duhet të jetë në përputhje me Shtojcën 3.

5.4.2 Shtetet duhet të promovojnë krijimin e rrjeteve për shkëmbimin apo ndarjen e informatave ndërmjet përdoruesve të sistemit të aviacionit dhe të lehtësojnë ndarjen dhe shkëmbimin e informatave të sigurisë, përveç nëse ligji kombëtar e parasheh ndryshe.

*Shënim.- Informacionet mbi shkëmbimin e informatave të sigurisë mund të gjenden në Kodin e Mirësjelljes të ICAO-s mbi Shkëmbimin dhe Përdorimin e Informatave të Sigurisë në Planin e Sigurisë së Aviacionit Global (Dok 10004).*

## **SHTOJCA 1. ELEMENTET KRITIKE (EK-të) TË SISTEMIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË SIGURISË (SshMS)**

*(Shih Kapitullin 3)*

*Shënim 1.- Udhëzuesi për elementët kritike (EK) të një sistemi që i mundëson një Shteti të ushtrrojë përgjegjësinë e tij për mbikëqyrjen e sigurisë gjendet në Manualin e Mbikëqyrjes së Sigurisë, Pjesa A, Themelimi dhe Menaxhimi i Sistemit të Mbikëqyrjes së Sigurisë së Shtetit (Dok 9734 ).*

*Shënim 2.- Termi "autoritete ose agjenci relevante" përdoret në kuptimin gjenerik për të përfshirë të gjitha autoritetet me përgjegjësi të menaxhimit dhe mbikëqyrjes të sigurisë së aviacionit që mund të përcaktohen nga shtetet si subjekte të ndara, siç janë: Autoritetet e Aviacionit Civil, Autoritetet e Aeroportit, Autoritetet ATS, Autoriteti për Hetimin e Aksidenteve dhe Autoriteti Meteorologjik.*

*Shënim 3.- EK të sistemit SHMS zbatohen në autoritetet që kryejnë funksione të mbikëqyrjes së sigurisë , sipas nevojës, si dhe autoritetet që kryejnë hetimin e aksidenteve dhe incidenteve ose aktiviteteve tjera të menaxhimit të sigurisë.*

*Shënim 4.- Shih Shtojcën 5 të Aneksit 6, Pjesa I dhe Shtojcën 1 të Aneksit 6, Pjesa III, për dispozita specifike për mbikëqyrjen e sigurisë të operatorëve ajrorë.*

### **1. Legjislacioni primar i aviacionit (EK-1)**

1.1 Shtetet duhet të nxjerrin një ligj gjithëpërfshirës dhe efektiv të aviacionit, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre të aviacionit dhe në përputhje me kërkesat e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, për të mundësuar mbikëqyrjen dhe menaxhimin e sigurisë së aviacionit civil dhe zbatimin e rregulloreve përmes autoriteteve ose agjencive përkatëse të themeluara për këtë qëllim.

*Shënim: Kjo përfshin sigurimin se ligji i aviacionit mbetet relevant dhe i përshtatshëm për shtetin.*

1.2 Ligji i aviacionit duhet ti sigurojë personelit që kryen funksionet e mbikëqyrjes së sigurisë qasje në aeroplan, operacione, objekte, shënime të personelit dhe, sipas nevojës, të dhëna përkatëse të individëve dhe organizatave që kryejnë një aktivitet të aviacionit.

### **2. Rregulloret specifike të operimit (EK-2)**

